



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:300493
Datë: 30.05.2024
Numri i dokumentit: 05760142

KP.nr. 22/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen juridike të Paditësit “Ndërmarrja Publike Banesore” me seli në Prishtinë të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Avokat Valdrin Behrami me seli në Prishtinë, kundër të paditurit N.T.P “Beni Dona Plast” me seli në Prishtinë të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Jeton Berisha i punësuar pranë të paditurës, me objekt kontesti Lirim i pronës dhe kthimi në gjendje të mëparshme, jashtë seance me datën 30.05.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

Konstatohet e tërhequr padia e paditësit “Ndërmarrja Publike Banesore” me seli në Prishtinë, e ushtruar më datën 17.07.2010, kundër të paditurit N.T.P “Beni Dona Plast” me seli në Prishtinë, për lirim të pronës dhe kthimin në gjendje të mëparshme.

Shpenzimet e procedurës mbeten barë e paditësit.

A r s y e t i m

Paditësi më datën 17.07.2010 pranë Gjykatës Komunale në Prishtinë ka ushtruar padi ndaj të paditurit N.T.P “Beni Dona Plast”, me të cilën ka kërkuar lirim të pronës dhe kthimin në gjendje të mëparshme.

I autorizuari i paditësit në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur më datën 23.05.2024 ka deklaruar se e tërheqë padinë për faktin se në këtë seancë janë dorëzuar provat materiale me të cilat vërtetohet fakti se pengesa – dera që ishte e vendosur e që ka penguar lëvizjen brenda objektit është larguar, dhe që hapësira është në përputhje të plotë me të gjeturat nga ekspertiza e

gjeodezisë, për këtë arsye ka deklaruar se nuk ka interes juridik për vazhdimin e këtij kontesti dhe mbi këtë bazë është tërhequr nga padia.

I autorizuari i të paditurit ka deklaruar se nuk e kundërshton tërheqjen e padisë dhe nuk kërkon shpenzime procedurale të krijuara përgjatë kësaj procedure.

Gjykata duke vepruar sipas deklaramit të autorizuarit të paditësit për tërheqje të padisë, dhe deklaramit të autorizuarit të paditurit lidhur me dhënien e pëlqimit për tërheqjet të padis, konstatoj se paditësi po e tërheq padinë, andaj konform nenit 261 të LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, ndërsa për shpenzimet vendosi në kuptim të nenit 450 të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Parë Departamenti i Përgjithshëm
KP.nr.22/23, datë 30.05.2024

Gjyqtari
Gent Bekeri

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.